



# KËSHILLA DHE INFORMACIONE PËR MBAJTJEN E KAFSHËVE SHTËPIAKE

---



Animals Need Me është një organizatë vullnetare, e cila lufton për të drejtat dhe mirëqenien e kafshëve endacake në qytetin e Shkodrës që prej vitit 2012.

Qëllimi i këtij udhëzuesi, është të ndajë informacione dhe këshilla se si t'i mirëmbajmë kafshët tona shtëpiake.

Duke e mbajtur kafshën tuaj të shëndetshme, ju mbani veten dhe familjen tuaj të shëndetshëm.

Kontaktoni veterinerin tuaj nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me shëndetin e kafshës suaj ose nëse mendoni se kafsha juaj mund të jetë e sëmurë.

Shënim: Doracaku do të pasurohet dhe përmirësohet vazhdimisht.



## **Animals Need Me**

# PËRMBATJA

PREJARDHJA E KAFSHËVE SHTËPIAKE .....	5
PËRFITIMET SHËNDETËSORE TË MBAJTJES SË KAFSHËVE SHTËPIAKE .....	7
KUSHTET PËR TË ADOPTUAR NJË QEN .....	9
KUSHTET PËR TË ADOPTUAR NJË MACE .....	11
PERIUDHA E PËRSHTATJES PAS ADOPTIMIT .....	13
STERILIZIMI I KAFSHËVE SHTËPIAKE .....	14
RËNDËSIA E STERILIZIMIT PËR QENTË .....	16
RËNDËSIA E STERILIZIMIT PËR MACET .....	18
RËNDËSIA E VAKSINIMIT TË KAFSHËVE SHTËPIAKE .....	20
SHENJAT SHËNDETËSORE TEK MACET .....	22
SHENJAT SHËNDETËSORE TEK QENTË .....	23
USHQYERJA E QENVE .....	24
USHQYERJA E MACEVE .....	27
KËSHILLA PËR KUR HUMBIM MACEN .....	31
KËSHILLA PËR KUR HUMBIM QENIN .....	33
PRENZANTIMI MIDIS KAFSHËVE .....	35
KUJDESI NDAJ KOTELEVE .....	39
MACET DHE RËRA .....	41
KUJDESI NDAJ KËLYSHËVE .....	42
SI TË MËSOJMË QENTË TË KRYEJNË NEVOJAT JASHTË .....	44
RËNDËSIA E AKTIVITETIT FIZIK PËR QENTË .....	46
RËNDËSIA E AKTIVITETIT FIZIK PËR MACET .....	49
BIMË HELMUJESË PËR KAFSHËT SHTËPIAKE .....	51
SHKALLA E AGRESIONIT TE QENTË .....	53
QENTË NUK MBAHEN TË LIDHUR! .....	55

KAFSHËT DHE FISHEKZJARRET .....	56
SI TË KUJDESENI PËR KAFSHËT ENDACAKE GJATË MOTIT TË NXEHTË .....	57
SI TË KUJDESENI PËR KAFSHËT ENDACAKE GJATË MOTIT TË FTOHTË .....	58
MACE E HUMBUR APO ENDACAKE?.....	59
MIRËMBAJTJA E LEPUJVE .....	60
LISTA E VETERINERËVE NË SHQIPËRI.....	64
REFERENCAT .....	66

## PREJARDHJA E KAFSHËVE SHTËPIAKE

Njerëzit i kanë zbutur kafshët për disa qëllime: ushqim (mish dhe qumësht), punë, transport, kontroll të dëmtuesve (minjtë) dhe shoqërim. Zbutjet më të hershme mund të gjurmohen në një periudhë të historisë kur njerëzit filluan të kalonin nga një shoqëri gjuetar-mbledhëse në një shoqëri bujqësore.

## PREJARDHJA E QENVE



Provat gjenetike sugjerojnë se qentë erdhën drejtpërdrejt nga ujqit (*Canis lupus familiaris*). Koha dhe vendndodhja e zbutjes së qenve është e debatueshme. Megjithatë, ka prova të forta gjenetike që ngjarjet e para të zbutjes ndodhën diku në Euroazinë veriore rreth 15.000 vite më parë. Në këtë rajon, ujqit e lehtësuan zbutjen e tyre duke ndjekur njerëzit nomadë në Euroazinë veriore dhe duke konsumuar mbetjet e kafshëve të gjahut që gjuetarët linin pas.

Shumica e studimeve pajtohen se zbutja nuk ishte një ngjarje e vetme. Ishte një proces që

u shpalos gjatë mijëra viteve.

Qentë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e qytetërimit njerëzor dhe janë ndër kafshët e para të zbutura. Ata ishin të rëndësishëm në shoqëritë e gjuetarëve-mbledhësve si aleatë gjuetie dhe truproje kundër grabitqarëve. Kur bagëtitë u zbutën rreth 7.000 - 9.000 vjet më parë, qentë shërbenin si barinj dhe kujdestarë të deleve, dhive dhe bagëtime. Edhe pse shumë, ende shërbejnë në këto kapacitete, qentë përdoren kryesisht për qëllime shoqërore. Sot qentë veprojnë si udhërrëfyes për të verbërit dhe

invalidët ose në polici. Qentë përdoren edhe për terapi në shtëpi të moshuarish dhe spitale për të inkurajuar pacientët drejt shërimit.

## PREJARDHJA E MACEVE

Macja shtëpiake, siç e njohim ne sot, rrjedh nga një mace e egër me origjinë afrikane (*Felis silvestris libyca*), procesi evolucionar i së cilës filloi rreth 6 milionë vjet më parë. Mendohet se zbutja e maces filloi 6.000 - 10.000 vite më parë.

Zbutja e maces ndodhi kur popullatat njerëzore krijuan vendbanimet e para rurale dhe burrat u bënë fermerë nga gjuetar nomadë që kishin qenë deri atëherë. Në komunitetet e para bujqësore lindi nevoja për të ndërtuar hambarë për ruajtjen e drithërave dhe kjo, pothuajse me siguri, çoi në grumbullimin e brejtësve. Fermerët me sa duket inkurajuan qëndrimin e



maceve, duke u kujdesur për to, në mënyrë që të përfitonin nga aftësitë e tyre në gjuetinë e minjve, të cilët përfaqësonin një kërcënim serioz.

Macet u sollën me vete në anije, me shumë gjasa për të ndihmuar në mbrojtjen e depozitave të ushqimit në bord duke vrrarë brejtësit. Kjo bëri që macet të përhapeshin në të gjithë botën.

Personaliteti i pavarur, hiri, pastërtia dhe shfaqja delikate e dashurisë së maceve, janë arsye të paktën shumë njerëz gëzojnë shoqërinë e saj.

## PËRFITIMET SHËNDËTËSORE TË MBAJTJES SË KAFSHËVE SHTËPIAKE


Mbajtja e një kafshe shtëpiake sigurisht ka një përgjegjësi të madhe, por hulumtimet sugjerojnë se mund të ketë edhe përfitime të rëndësishme shëndetësore fizike dhe psikologjike.

Kafshët shtëpiake mund të ulin stresin dhe ndjenjën e vetmisë, të përmirësojnë shëndetin e zemrës dhe madje të ndihmojnë fëmijët me aftësitë e tyre emocionale dhe sociale.




### PËRFITIMET FIZIKE

- 🐾 Rritja e shëndetit kardiovaskular (ulje e presionit të gjakut, ulje e triglicerideve dhe tek meshkujt ulje e kolesterolit).
- 🐾 Rritja e aktivitetit fizik. Qentë veçanërisht, na ndihmojnë të dalim shëtitje dhe të shijojmë natyrën, ndërsa bëjmë disa ushtrime të rregullta.
- 🐾 Rritja me kafshë shtëpiake gjatë fëmijërisë mund të ndihmojë në forcimin e sistemit imunitar dhe mund të zvogëlojë rrezikun e alergjive.



## PËRFITIMET PSIKOLOGJIKE

- ❗ Ata që kanë kafshë shtëpiake, duke përfshirë fëmijë ose adoleshentë, kanë rezultuar të kenë vetëbesim më të lartë. Adoleshentët që kanë kafshë shtëpiake kanë një pikëpamje më pozitive për jetën dhe tregojnë më pak vetmi, shqetësim, dëshpërim dhe mërzë.
- ❗ Pronarët e kafshëve shtëpiake raportojnë më pak depresion dhe duket se e përballojnë pikëllimin, stresin apo humbjen më mirë se ata që nuk kanë kafshë në shtëpi.
- ❗ Kafshët shtëpiake përmirësojnë aftësitë sociale dhe janë iniciatorë të shkëlqyeshëm bisedash.
- ❗ Kafshët shtëpiake janë gjithashtu kujdestarë të shkëlqyer. Ata na bëjnë shoqëri kur jemi të sëmurë ose ndihemi keq. Mund të na bëjnë të ndihemi të sigurt ndërsa jemi vetëm në shtëpi.



## KUSHTET PËR TË ADOPTUAR NJË QEN

Të kesh një qen është një angazhim i madh, por edhe tepër shpërblyes. Pavarësisht nëse jeni pronar qeni për herë të parë, ose me përvojë, ju duhet t'i siguroni kushtet optimale të jetesës:

- ❖ Duhet t'i lini minimalisht 2 javë kohë që të ambientohet me shtëpinë e re.
- ❖ Nëse qeni do të jetojë në oborr, duhet të ketë një kolibe të pastër, me mundësi mbrojtjeje nga i nxehti, i ftohti, shiu, era dhe bora.
- ❖ Nëse jetoni në apartament, duhet ta shëtisni 2 herë në ditë për të kryer nevojat e tij.
- ❖ Të mos mbahet i lidhur, pasi mungesa e lirisë është më keq se jeta në rrugë.
- ❖ Të ushqehet 1-2 herë në ditë dhe të ketë një kovë me ujë të pastër që i ndërrohet çdo ditë.
- ❖ Të mos ushqehet me kocka sepse i dëmtojnë sistemin tretës dhe mund edhe të vdesë.
- ❖ Të mos ushqehet me qumësht sepse u krijohen parazitë të brendshëm.
- ❖ Qeni ka nevojë për 3 vaksina vitin e parë të jetës dhe 1 çdo vit që pason.
- ❖ Ka nevojë për hap antiparazitar çdo 3-4 muaj dhe pastrim nga pleshtat ose rriqnat, në pranverë ose vjeshtë (nëse shfaq ndonjë).
- ❖ Pavarësisht gjinisë, çdo qen duhet të sterilizohet pasi mbush moshën 6 muaj.



- 🐾 Nëse keni pula dhe lepuj në shtëpi, bashkëjetesa e tyre është e vështirë ndaj duhet të bëni një rrethim të posaçëm për ta ose për qenin.
- 🐾 Qentë janë shumë të ndjeshëm dhe lidhen fort me të zotin e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes adoptuese, ndaj është e rëndësishme që t'i kushtohet kohë duke i përkëdhelur dhe treguar dashuri.

## KUSHTET PËR TË ADOPTUAR NJË MACE

Për të adoptuar një mace duhet të përpiqeni t'i siguron kushtet optimale të jetesës:

- ❖ Orët e para pas sjelljes së maces në shtëpi mund të ndikojnë se sa mirë do e pranojë jetën e saj të re.
- ❖ Së pari, jini të durueshëm dhe mos u përpiqni kurrë ta nxitoni macen tuaj të bëjë gjëra për të cilat mund të mos jetë gati.
- ❖ Pavarësisht se u pëlqen liria, macet duhet të mbahen brenda në shtëpi dhe me raste mund të nxirren në oborr, nëse jetoni në shtëpi private.
- ❖ Duhet të kenë kutinë e tyre të rërës në banjo, për të kryer nevojat. Kjo kuti duhet të pastrohet me rigorozitet rregullisht dhe rëra të ndërrohet çdo 3-4 ditë.
- ❖ Të ushqehet 3 herë në ditë dhe të ketë një tas me ujë të pastër që i ndërrohet çdo ditë.
- ❖ Të mos ushqehet me hala peshku sepse i shkatërrojnë sistemin tretës dhe mund të vdesë si pasojë.
- ❖ Të mos ushqehet me qumësht sepse është i dëmshëm për macet. Ato janë intolerante ndaj laktozës.
- ❖ Macja ka nevojë për 2 vaksina vitin e parë të jetës dhe 1 çdo vit që pason. Ka nevojë për hap antiparazitar çdo 3-4 muaj dhe pastrim nga pleshtat në pranverë ose vjeshtë (nëse shfaq ndonjë).
- ❖ Pavarësisht gjinisë, çdo mace duhet të sterilizohet pasi mbush moshën 6 muaj;



- 🐾 Nëse keni zogj në shtëpi, bashkëjetesa e tyre është e vështirë ndaj duhet të bëni kujdes.
- 🐾 Macet kanë nevojë për shumë kohë për t'u përshtatur me ambientin e tyre të ri. Prandaj, për të evituar që ata të tentojnë të kthehen në ambientin e vjetër, apo të humbasin ose të aksidentohen, është e nevojshme t'i mbani brënda në shtëpi për të paktën dy javë pas adoptimit.

## PERIUDHA E PËRSHTATJES PAS ADOPTIMIT

Rregulli 3/3/3 është një udhëzues i përgjithshëm për periudhën e përshtatjes së një kafshe shtëpiake pas adoptimit. Çdo kafshë është unike dhe do të përshtatet ndryshe. Ju lutemi kini durim dhe jepuni kohë të ambientohen.

### 3 ditë për t'u relaksuar

- 🐾 Ndihen të mbingarkuar nga ana psikologjike.
- 🐾 Mund të ndihen të frikësuar ose të pasigurtë për atë që po ndodh.
- 🐾 Ende jo rehat për të qenë "vetvetja".
- 🐾 Mund të mos dëshirojnë të hanë ose të pinë.
- 🐾 Mbyllen dhe/ose fshihen nën mobilje.
- 🐾 Testojnë kufinj të ambientit.



### 3 javë për të mësuar rutinën tuaj

- 🐾 Fillojnë të ambientohen.
- 🐾 Ndihen më rehat.
- 🐾 E kuptojnë që kjo mund të jetë shtëpia e tyre përgjithmonë.
- 🐾 Kuptojnë ambientin e tyre përreth.
- 🐾 Fillojnë e ndërtojnë një rutinë.
- 🐾 Fillojnë të shfaqin personalitetin e tyre të vërtetë.
- 🐾 Mund të shfaqin probleme në sjellje.



### 3 muaj për t'u ndjerë në shtëpinë e tyre

- 🐾 Më në fund ndihen plotësisht rehat në shtëpi.
- 🐾 Fillojnë të ndërtojnë besim dhe lidhje me pronarët.
- 🐾 Fitojnë një ndjenjë të plotë sigurie me familjen e tyre të re.
- 🐾 Stabilizojnë një rutinë



## STERILIZIMI I KAFSHËVE SHTËPIAKE

Një qen femër i pasterilizuar dhe këlyshët e saj, mund të gjenerojë 67.000 këlyshë të padëshiruar në 6 vite. Një mace e pasterilizuar, bashkë me bebet e saj, mund të gjenerojë 420.000 kotele.

Shumë nuk ia dalin të mbijetojnë, ndërsa një pjesë jetojnë të sëmurë. Ata që mbijetojnë, vazhdojnë të përsërisin ciklin.

**Vetëm sterilizimi mund ta frenojë mbipopullimin e kafshëve shtëpiake.**



Sterilizimi mund të parandalojë që mijëra kafshë të lindin vetëm për të vuajtur dhe luftuar për të mbijetuar rrugëve, ose për t'u abuzuar nga njerëz mizorë dhe neglizhues.

Sterilizimi është një procedurë kirurgjikale për të parandaluar riprodhimin e kafshëve. Operacioni kryhet nga një veteriner nën anestezi të përgjithshme. Meshkujve u hiqen testikujt e tyre, ndërsa femrave u hiqen vezoret (ndonjëherë edhe mitra).

Veterineri juaj do të jetë në gjendje t'ju japë këshilla për t'u siguruar që kafsha juaj është gati t'i nënshtrohet operacionit dhe se si mund t'i ndihmoni ata të shërohen në shtëpi.

### KEQKUPTIME TË ZAKONSHME MBI STERILIZIMIN

*DUHET TË PRES DERISA QENI OSE MACJA IME FEMËR TË LINDË NJËHERË PËRPARA SE TA STERILIZOJ?*

Në fakt është më mirë që femrat të sterilizohen para se të jenë të pjekura seksualisht, sepse sterilizimi zvogëlon rrezikun e disa llojeve të kancerit tek qentë dhe macet femra deri në 85%.

### *DO TË NDRYSHOJË PERSONALITETIN E KAFSHËS SUAJ?*

Sterilizimi nuk ka asnjë ndikim në personalitetin e kafshës suaj. Procedurat do të zvogëlojnë ose eliminojnë disa sjellje të padëshiruara (agresioni, urinimin vend e pavend, të enden rrugëve, etj.).

### *A ËSHTË STERILIZIMI I SIGURT?*

Këto procedura janë tashmë operacionet më të zakonshme të kryera nga veterinerët. Kafsha juaj do të përjetojë relativisht pak dhimbje dhe paresthi, por do t'i kthehet aktiviteteve normale brenda pak ditësh në shumicën e rasteve.

### *A ËSHTË KOSTOJA SHUMË E LARTË?*

Krahasuar me koston e mbajtjes dhe kujdesit për një lindje (ose më keq, të braktisni një pjellë në rrugë), sterilizimi është padyshim një zgjedhje më ekonomike dhe më e përgjegjshme.

### *STERILIZIMI DO TË BËJË QË KAFSHA IME TË SHTOJË PESHË?*

Mungesa e stërvitjes dhe ushqyerja e tepërt do të bëjë që kafsha juaj të shtojë peshë - jo sterilizimi. Kafsha juaj do të mbetet në formë për sa kohë që ju vazhdoni ta ushtroni dhe të monitoroni ushqyerjen.

### *STERILIZIMI A E ZVOGËLON 'MANKILITETIN' E NJË KAFSHE?*

Ndryshe nga njerëzit, kafshët nuk kanë asnjë koncept aktual të seksualitetit të tyre dhe sterilizimi nuk do të ndryshojë prirjen natyrore të kafshës suaj. Për shembull, sterilizimi i qenve meshkuj nuk i bën ata të padobishëm për mbrojtje.

Sterilizimi gjithashtu nuk ka asnjë efekt në instinktin natyror të një kafshe. Inteligjenca dhe personaliteti i një qeni formohet më shumë nga gjenetika dhe faktorët mjedisorë sesa nga hormonet seksuale.

## RËNDËSIA E STERILIZIMIT PËR QENTË

Sterilizimi është një operacion i thjeshtë që ka shumë përfitime shëndetësore dhe të sjelljes tek qeni, si dhe ndalon çdo lindje të padëshiruar.



### PËR QENTË MESHKUJ

- ✿ Sterilizimi zvogëlon ndjeshëm mundësinë që ata të marrin sëmundje të prostatës dhe zvogëlon rrezikun e disa kancereve.
- ✿ Qentë meshkuj të sterilizuar rrezikojnë më pak nga tumoret e testikujve.
- ✿ Sterilizimi mund të ketë një efekt të dobishëm në sjellje.
- ✿ Qeni juaj ka më pak gjasa të endet, të urinojë vend e pavend ose të jetë agresiv.

### PËR QENTË FEMRA

- ✿ Sterilizimi zvogëlon në masë të madhe rrezikun e prekjes nga kanceri i gjirit.
- ✿ Ka prova që sugjerojnë se sterilizimi para 2.5 viteve të para të jetës zvogëlon rreziqet e kancerit të gjirit deri në 10 herë më pak.
- ✿ Kanceri i gjirit është mjaft i shpeshtë në qentë e moshuar, të pa sterilizuar, dhe mund të jetë fatal.
- ✿ Sterilizimi i qenit tuaj eliminon rrezikun e një infeksioni të mitrës (i quajtur piometra), për të cilin studimet tregojnë se prek deri në 25% qentë femra të pa sterilizuara dhe mund të jetë vdekjeprurës.
- ✿ Nëse qenushja juaj vuan nga piometra dhe duhet të sterilizohet si pjesë e trajtimit, kjo do të jetë më e shtrenjtë sesa sterilizimi e një qeni të shëndetshëm.

- 🐾 Shtatzania dhe lindja mund të jenë të rrezikshme për qenin tuaj.
- 🐾 Shumë qen femra të pa sterilizuara, kanë një shtatzani të rreme pas një sezoni afshi dhe megjithëse kjo është e natyrshme, mund të shkaktojë probleme të sjelljes madje edhe mjekësore.

## RËNDËSIA E STERILIZIMIT PËR MACET

Sterilizimi i maces tuaj është i mirë për shëndetin dhe sjelljen e tyre të përgjithshme, por edhe për të ndaluar lindjen e koteleve të padëshiruara.



### PËR MACET FEMRA

- ❗ Sterilizimi i maces tuaj femër është mënyra më e mirë për të parandaluar shtatzanitë e padëshiruara.
- ❗ Nëse macja juaj mbetet shtatzanë, kjo vjen me një përgjegjësi shtesë dhe merak, pasi do t'ju duhet të kujdeseni për të gjatë shtatzanisë, lindjes dhe më pas për kotelet e saj.
- ❗ Sterilizimi i maceve, veçanërisht nëse bëhet kur janë të reja, zvogëlon shumë rrezikun që ata të preken nga kanceri i gjirit dhe infeksioni i mitrës (i quajtur piometra). Të dyja këto mund të jenë vdekjeprurëse.
- ❗ Macet e sterilizuara nuk do të mjaulljnë ose vajtojnë, siç bëjnë macet e pa sterilizuara kur janë në afsh (periudha e çiftimit).

### PËR MACET MESHKUJ

- ❗ Sterilizimi zvogëlon mundësinë për të kapur virusin e mungesës së imunitetit të maceve (FIV). Kjo është një sëmundje e pashërueshme, e cila përhapet nëpërmjet pështymës, zakonisht nga plagët e kafshimit gjatë luftimeve.
- ❗ Maçokët e pasterilizuar që mbahen në apartament, mund të dëshpërohen aq shumë sa mund të provojnë çdo rrugë shpëtimi - përfshirë edhe të hidhen nga dritarja e kateve të larta.

- 🐾 Shpesh shfaqen të acaruar nëse nuk gjejnë një shoqe femër dhe mund të spërkasin me urinë me erë të rëndë në shtëpi, si një fomë apeli për macet femra.
- 🐾 Sterilizimi i maçokëve zvogëlon dëshirën e tyre për të bredhur dhe për të luftuar kështu që ka më pak mundësi të humbasin, të aksidentohen nga makinat ose të lëndohen.

## RËNDËSIA E VAKSINIT TË KAFSHËVE SHTËPIAKE

Qentë dhe macet kanë nevojë për vaksinime kundër sëmundjeve të rrezikshme virale dhe bakteriale.

Këlyshët dhe kotelet janë shumë të ndjeshëm ndaj sëmundjeve infektive. Kjo është veçanërisht e vërtetë, pasi imuniteti natyror i siguruar në qumështin e nënave të tyre, gradualisht shuhet. Për të siguruar mbrojtje optimale ndaj sëmundjeve për muajt e parë të jetës, janë planifikuar një seri vaksinimesh, zakonisht 3-4 javë larg njëra - tjetrës.



### VAKSINAT PËR QENTË

- 🐾 Këlyshët do të duhet të vaksinohen duke nisur nga mosha 6 deri në 8 javësh.
- 🐾 Zakonisht nevojiten 3 vakcina me një hark kohor prej 21 ditësh ndërmjet njëra-tjetrës
- 🐾 Këto vakcina do të mbrojnë qentë kundër lisë, parvovirozës, leptospirozës dhe hepatitit infektiv. Një vaksinë kundra tërbimit do të duhet nëse udhëtoni jashtë vendit.
- 🐾 Vaksinat përforcuese janë të nevojshme të përsëriten 1 herë në vit.
- 🐾 Nëse nuk e dini nëse qeni juaj është vaksinuar, nuk dëmton të përsërisni vaksinat.

### VAKSINAT PËR MACET


- 🐾 Vaksinat e para polivalente duhet t'u bëhen koteleve duke nisur që 2 muaj pas lindjes.

- 🐾 Vaksinat e maceve do të ndihmojnë në mbrojtjen nga këto sëmundje kryesore infektive: panleukopeni, calicivirus, herpesvirus. Këto tre vaksina janë të bashkuara në një vaksinë polivalente.
- 🐾 Zakonisht nevojiten 2 vaksina - me nga tre deri në katër javë në distancë kohore nga njëra - tjetra. Një vaksinë e tretë kundra tërbimit do të duhet nëse udhëtoni jashtë shtetit
- 🐾 Pastaj një vaksinë përforcuese duhet të bëhet 1 herë çdo vit, për të mbajtur nivelin e imunitetit të lartë.

## SHENJAT SHËNDETËSORE TEK MACET

Lexoni sa vijon më poshtë për t'u siguruar që macja juaj është e shëndetshme:

- ❖ **Sytë** - të ndritshëm dhe të pastër, pa asnjë shenjë skuqjeje ose rrjedhjeje.
- ❖ **Veshët** - të pastër dhe pa erë.
- ❖ **Hunda** - e pastër dhe pa sekrecione.
- ❖ **Goja** - pa asnjë shenjë rrjedhjeje. Kontrolloni brenda për dhimbje të mishit të dhëmbëve.
- ❖ **Lëkura** - e pastër, pa shenja pezmatimi, mungesë qimesh apo shenja parazitësh.
- ❖ **Qimja** - e pastër dhe me shkëlqim.
- ❖ **Frymëmarrja** - e rregullt dhe e barabartë. Frymëmarrja e vështirë mund të tregojë një infeksion respirator.
- ❖ **Barku** - i mbushur mirë por jo i fryrë, pasi kjo mund të dëshmojë parazitë të brendshëm.
- ❖ **Anusi** - ndotja ose dhimbja mund të tregojnë se macja vuan nga diarrea.
- ❖ **Lëvizja** - e lirë dhe e lehtë, pa asnjë gjurmë ngurtësie ose çalimi.



## SHENJAT SHËNDETËSORE TEK QENTË

Lexoni sa vijon më poshtë për t'u siguruar që qeni juaj është i shëndetshëm:

- ❃ **Sytë** - duhet të jenë të gjerë, të ndritshëm dhe vigjilentë. Nuk duhet të ketë asnjë shenje sekrecioni.
- ❃ **Veshët** - të pastër, pa asnjë erë të keqe. Kontrolloni që të përgjigjen ndaj llojeve të ndryshme të tingujve.
- ❃ **Dhëmbët** - duhet të jenë të pastër dhe mishrat e dhëmbëve pa plagë, gjakderdhje ose inflamacion.
- ❃ **Hunda** - nuk ka asnjë shenjë koreje ose rrjedhjeje.
- ❃ **Qimja** - e pastër dhe me erë të freskët (d.m.th. nuk ka erë urine apo feçesh).
- ❃ **Trupi** - Të gjithë qentë duhet të jenë të mbushur, pa u dukur shumë të trashë apo shumë të hollë. Barku i fryrë mund të tregojë parazitë të brendshëm. Qentë duhet të lëvizin pa sforcim dhe pa shenja çalimi.
- ❃ **Thonjtë** - të lakuar dhe jo të drejtë. Nuk duhet të jenë shumë të gjatë, të thyer apo të dëmtuar.
- ❃ **Temperamenti** - Qentë janë vigjilentë dhe lozonjarë.
- ❃ **Anusi** - Pjesa e pasme është e pastër (qimja e papastër mund të tregojë diarre).



## USHQYERJA E QENVE

Ashtu si njerëzit, qentë kanë nevoja shumë specifike kur bëhet fjalë për ushqimin e tyre. Zgjedhja e një diete me cilësi të lartë, të ekuilibruar dhe të diturit se sa duhet të konsumojnë, është thelbësore për të ruajtur peshën e tyre, për të parandaluar probleme të mëtejshme shëndetësore dhe për t'u siguruar që trupi i tyre të marrë të gjitha lëndët ushqyese që i nevojiten.

Qentë janë omnivorë (gjithçkangrënës), kështu që kanë aftësinë për të tretur mishin dhe perimet. Prandaj, ata kanë nevojë për një dietë të ekuilibrar me proteina, yndyrna, fibra, minerale dhe vitamina.



### USHQIMI I THATË APO I LAGËSHT?

Ekzistojnë lloje të ndryshme të ushqimit për qen në dispozicion, por ushqimet e thata me përshkrimin "i plotë", janë zakonisht alternativa më e mirë.



Këto përmbajnë të gjitha lëndët ushqyese që i nevojiten qenit tuaj, në një formë të përshtatshme që është e lehtë për t'u ruajtur. Ato janë gjithashtu shumë më të mira për shëndetin e dhëmbëve të qenit tuaj sesa ushqimi i lagësht pasi ndihmojnë në heqjen e papastërtive dhe gurëzave nga dhëmbët. Ushqimi i thatë përmban

gjithashtu shumë më pak ujë dhe një përqendrim më të lartë të lëndëve ushqyese.

Për shkak të përmbajtjes së lartë të ujit, ushqimi i lagësht mund të jetë një opsion i mirë për qentë që nuk pinë mjaftueshëm. Ushqimi i lagësht është gjithashtu më i lehtë për t'u ngrënë për qentë që po shërohen nga një sëmundje ose operacion.

Shumë pronarë zgjedhin një përzierje të të dyjave.

---

## SASIA E USHQYERJES

Sasia që duhet të hajë qeni juaj lidhet me racën, moshën dhe madhësinë e tij. Të gjitha ushqimet e qenve kanë udhëzime në paketimin e tyre, dhe kjo është zakonisht një pikë e mirë për të filluar. Më pas do t'ju duhet t'i vëzhgoni dhe të orientoheni në bazë të peshës së tyre, për të kuptuar nëse po hanë shumë apo pak.

---

## FREKUENCA E USHQYERJES


Pasi të keni vendosur se sa duhet të hajë qeni juaj, atëherë mund ta ndani këtë në vakte të vogla gjatë gjithë ditës. Kjo është fleksibël, por dy ose tre vakte në ditë ndihmojnë në shmangien e fryrjes (një sëmundje potencialisht fatale e njohur ndryshe si përdredhje gastrike) e cila është lidhur me ushqyerjen e një vakti të madh në ditë.

---

## NDRYSHIMI I USHQIMIT

Nëse ju duhet të ndryshoni ushqimin e tyre për çfarëdo arsye, është e rëndësishme që ta bëni këtë gradualisht pasi një ndryshim i papritur në dietë, mund t'u shqetësojë stomakun dhe t'i shtyjë ata të heqin dorë nga ushqimi.

Filloni duke shtuar një sasi të vogël ushqimi të ri në ushqimin e tyre të zakonshëm. Rritni gradualisht sasinë e ushqimit të ri që u jepni (ndërsa ulni sasinë e ushqimit të vjetër) gjatë një jave, derisa të hanë vetëm ushqimin e ri.



#### HIDRATIMI

Uji është një pjesë thelbësore e të ushqyerit të qenit tuaj dhe mos pirja e mjaftueshme sjell pasoja të rënda. Shumica e qenve pinë mjaftueshëm ujë, por disa mund të mos pinë, kështu që mund t'ju duhet të gjeni mënyra për t'i inkurajuar në mënyrë aktive që të hidratohen: duke vendosur tasa me ujë në të gjithë shtëpinë dhe oborr, ose duke shtuar një sasi të vogël uji në ushqimin e thatë.

#### USHQIMET TË DËNSHME PËR QENTË

*Edhe pse është joshëse t'i jepni qenit ushqime nga pjata juaj, duhet të dini se disa ushqime të zakonshme njerëzore, janë të dënshe dhe duhen të shmangen rreptësisht. Ato janë: arrat, qepët, rrushi i thatë, çokollata, preshtë, hudhrat, kockat dhe halët e peshkut.*

## USHQYERJA E MACEVE

Ushqyerja e maceve tuaja me dietën e duhur mund t'ju ndihmojë t'i mbani ato të shëndetshme për vitet në vijim. Jo vetëm që lloji i duhur i dietës u jep maceve të gjitha lëndët ushqyese që u nevojiten, por gjithashtu mund të ndihmojë në përmirësimin e shëndetit të dhëmbëve dhe rregullimin e sistemit të tyre tretës.



Të gjitha macet janë mishngrënëse, që do të thotë se kanë nevojë për vitamina, minerale dhe proteina specifike (për shembull taurinë dhe argininë) që vijnë vetëm nga mishi. Pa këto lëndë ushqyese thelbësore, macja juaj mund të sëmuret rëndë.

### USHQIMI I THATË APO I LAGËSHT?

Kur bëhet fjalë për ushqimin, shumë mace janë tejet të qarta se çfarë u pëlqen, ndaj është mirë që të lihet në preferencën e tyre. Ushqimi i thatë është i përshtatshëm për t'u ruajtur dhe ka tendencë të jetë më i mirë për shëndetin e dhëmbëve të maces, pasi struktura e fortë ndihmon në heqjen pllakëzave dhe gurëzave nga dhëmbët. Ai gjithashtu përmban shumë më pak ujë dhe ka një përqendrim më të lartë të lëndëve ushqyese.



Nga ana tjetër, macet shpesh nuk pinë ujë të mjaftueshëm, kështu që ushqimi i lagësht mund t'i ndihmojë të jenë të hidratuara. Është gjithashtu shumë më i lehtë për t'u ngrënë për macet që po shërohen nga një sëmundje ose operacion.

Shumë pronarë zgjedhin një përzierje të të dyjave.

## SASIA E USHQYERJES

Sasia që duhet të hajë macja juaj lidhet me racën, moshën dhe madhësinë e saj. Të gjitha ushqimet e maceve kanë udhëzime në paketim që mund t'ju ndihmojnë të vendosni se sa ta ushqeni atë. Më pas do t'ju duhet ta vëzhgoni dhe orientoheni në bazë të peshës së tyre për të kuptuar nëse po hanë shumë apo pak.

## FREKUENCA E USHQYERJES

Pasi të keni vendosur se sa duhet të hajë macja juaj, mund ta ndani ushqimin në vakte të vogla gjatë gjithë ditës. Kjo është përgjithësisht fleksibël, por ka dy qasje të ndryshme që mund të merrni:

- Ushqyerja me kontroll, ku sasia e tyre ditore ndahet në vakte të caktuara, zakonisht dy në ditë.
- Ushqyerja e lirshme, ku ushqimi (zakonisht i thatë) është i disponueshëm gjatë gjithë ditës.




Ushqyerja me kontroll të porcioneve, është zakonisht alternativa më e mirë për shumicën e maceve, pasi mund të parandalojë ngrënien e tepërt dhe u jep pronarëve mundësinë të mbajnë nën kontroll zakonet e të ngrënit të maceve të tyre.

Nëse keni më shumë se një mace, ju sugjerojmë të siguroheni që të gjitha të hanë porcionin e tyre. Nuk është e pazakontë që një mace të hajë shpejt dhe ta shtyjë tjetrën për t'i ngrënë ushqimin.

## NDRYSHIMI I USHQIMIT

Nëse ju duhet të ndryshoni ushqimin e tyre për çfarëdo arsyeje, është e rëndësishme që ta bëni këtë gradualisht pasi një ndryshim i papritur në dietë, mund t'i shqetësojë stomakun dhe t'i shtyjë ata të heqin dorë nga ushqimi.

Filloni duke shtuar një sasi të vogël ushqimi të ri në ushqimin e tyre të zakonshëm. Rritni gradualisht sasinë e ushqimit të ri që u jepni (ndërsa ulni sasinë e ushqimit të vjetër) gjatë një jave, derisa të hanë vetëm ushqimin e ri.



## HIDRATIMI

Uji është një pjesë thelbësore e ushqimit të maces suaj, dhe mos pirja e mjaftueshme sjell pasoja të rënda.

Sigurohuni që uji i tyre të jetë gjithmonë i freskët, i pastër dhe lehtësisht i aksesueshëm për të inkurajuar pirjen e rregullt. Një tjetër ide e mirë është të siguroni tasa me ujë në vende të ndryshme në shtëpinë tuaj, pasi kjo do të inkurajojë të pijnë më shumë ujë.

Në disa raste, mungesa e etjes mund të jetë një shenjë e një problemi. Gjithmonë flisni me veterinerin tuaj nëse keni ndonjë shqetësim.

## MACET DHE QUMËSHTI

Përkundër besimit popullor, qumështi nuk është i mirë për macet. Në fakt, qumështi i lopës në të vërtetë është i dëmshëm për shëndetin e tyre, pavarësisht faktit se maceve u pëlqen shija e tij sepse ka shumë yndyrë.

Shumica e maceve janë intolerante ndaj laktozës (sheqeri i qumështit) sepse u mungojnë enzimat e duhura (proteina të prodhuara normalisht në zorrën e hollë për të tretur laktozën). **Prandaj konsumimi i produkteve të qumështit mund të çojë në diarre, të vjella dhe dehidrim.**

### *USHQIME TE DËMSHME PËR MACET*

*Mund të jetë tunduese të ndani copa nga ushqimi juaj me macen tuaj, por përpara se ta bëni këtë, sigurohuni që të mësoni se cilat ushqime mund të jenë toksike për macet. Ushqime si qepa, hudhra, qumështi i lopës, çokollata, avokado, rrushi, rrushi i thatë dhe ockat dhe halët e peshkut mund ta dëmtojnë macen tuaj.*

## KËSHILLA PËR KUR HUMBIM MACEN

Arsyet përse macet humbasin janë të ndryshme por kryesorja, është se macja nuk është e sterilizuar, prandaj tenton të ikë më shumë se ato mace që i janë nënshtruar operacionit.

- 🐾 **Kërkoni me kujdes brenda dhe jashtë shtëpisë tuaj** - Ndryshoni kohët e kërkimit, duke pasur parasysh që macet kanë tendencë të jenë më aktive natën vonë dhe herët në mëngjes, kur është qetë.
- 🐾 **Kërkojeni më mirë në qetësinë e natës** - Macet e humbura ndonjëherë ndihen më të sigurt të lënë vendet e tyre të fshehura natën. Dilni ta kërkoni kur është errët, duke e thirrur në emër.
- 🐾 **Kërkoni nga fqinjët leje për të kërkuar në pronën e tyre dhe përpiquni të zgjeroni kërkimin tuaj tre deri në pesë shtëpi në çdo drejtim.** Sigurohuni që të shikoni brenda garazheve ose strukturave të tjera ku një mace mund të bllokohet.
- 🐾 **Macet kanë një sens të fortë të nuhatjes** - Lini jashtë diçka me aromën e saj si batanijen ku flinte, rërën e përdorur apo një lodër të preferuar nga macja për ta inkurajuar të mos fshihet më.
- 🐾 **Lini jashtë një tas me ujë dhe pak ushqim.** Një vakt i shijshëm me mish mund të jetë i mjaftueshëm për ta sjellë macen tuaj në shtëpi. Shkundni një kuti me biskotat e tyre të preferuara për t'i tërhequr ata në shtëpi.
- 🐾 **Vendosni njoftime në zonën tuaj** me një foto të kohëve të fundit të maces tuaj dhe informacione se si mund t'ju kontaktojnë nëse macja juaj gjendet.



- 🐾 **Kontaktoni strehat dhe organizatat vullnetare** që merren me kafshët endacake. Mundet që dikush e ka gjetur macen dhe e ka sinjalizuar. Për më tepër, ata mund të postojnë macen tuaj të humbur në faqen e tyre.
- 🐾 **Kontaktoni veterinerët dhe njoftojini** që nëse dikush sjell një mace me karakteristikat e maces tuaj, t'ju kontaktojnë menjëherë

## KËSHILLA PËR KUR HUMBIM QENIN

Do të ishte ideale të vendosni një medalje në qaforen e qenit, në të cilën të shënoni numrin tuaj të telefonit. Kjo do të rriste shanset e ribashkimit me të në rast humbjeje.

❗ Së pari, nëse keni një qen të vogël, kontrolloni kudo që ata mund të fshihen brenda shtëpisë. Kërkoni zonat ku normalisht nxirrni qenin tuaj për shëtitje ose, nëse jeni zhvendosur kohët e fundit, pyesni përreth adresës tuaj të vjetër.

❗ Kërkojini fqinjëve tuaj të kontrollojnë kudo ku qeni juaj mund të jetë bllokuar siç janë rrethimet ose garazhet.

❗ Vendosni njoftime në zonën tuaj me një foto e kohëve të fundit të qenit dhe informacione se si mund t'ju kontaktojnë nëse ai gjendet.

❗ Kontaktoni strehat dhe organizatat vullnetare që merren me kafshët endacake. Mundet që dikush e ka gjetur qenin dhe e ka sinjalizuar. Për më tepër, ata mund të postojnë qenin tuaj të humbur në faqen e tyre.

❗ Mos hiqni dorë nga kërkimi - Qentë që kanë humbur prej muajsh janë ribashkuar me pronarët e tyre.

❗ Kërkoni në lagje - Kontrolloni në orare të ndryshme, ditën dhe natën.

❗ Merrni ushqime dhe lodrën e preferuar të qenit tuaj kur bëni kërkimin pasi aromat dhe tingujt e njohur mund ta lajmërojnë atë për praninë tuaj.



🐾 **Kontaktoni veterinerët** dhe njoftojini që nëse dikush sjell një qen me karakteristikat e qenit tuaj, t'ju kontaktojnë menjëherë.

## PREZANTIMI MIDIS KAFSHËVE

Pjesa më e rëndësishme e prezantimit është të mos e nxitoni procesin. Çdo detyrim ose nxitim nga ana juaj do ta bëjë situatën më stresuese dhe do ta zgjasë atë.

Ndiqni këto rregulla të përgjithshme për çdo lloj prezantimi midis kafshëve:

- 🐾 Gjithmonë bëni prezantimet në një mjedis të kontrolluar, ku kafshët nuk mund të arratisen.
- 🐾 Planifikoni prezantimin për një ditë kur jeni të lirshëm dhe mund ta kaloni sëbashku me kafshët.
- 🐾 Jini të durueshëm, flisni në mënyrë inkurajuese, me një zë të qetë dhe vlerësoni sjelljet e mira.
- 🐾 Për sigurinë e tyre, mbani kafshët shtëpiake të reja të ndara nga njëra-tjetra kur jeni larg shtëpisë.
- 🐾 Gjithmonë mbikqyrni ndërveprimet derisa të jeni 100% të sigurt se dy kafshët shtëpiake po shkojnë mirë.



## PREZANTIMI MACE ME KOTELE

Macet shënojnë territorin e tyre duke fërkuar kokën dhe fytyrën kudo - në dyer, mobilje, veshje - duke lënë aromën e tyre pas.


- 🐾 Përfshini aromën e koteles të re në aromat e shtëpisë tuaj, në mënyrë që macja juaj të mësohet me aromën e koteles.
- 🐾 Përkëdhelini shumë të dyja.

- ❗ Shkëmbejeni shpesh batanijet e tyre ose fshini kokën dhe fytyrën e koteles tuaj me një leckë dhe pastaj vendoseni atë leckë nën pjatën e ushqimit të maces tuaj ekzistuese.

## PREZANTIMI MACE ME MACE

Macet janë krijesa territoriale dhe zakonisht nuk u pëlqen të ndajnë hapësirën e tyre me macet e tjera.

- ❗ Ju mund të keni nevojë t'i mbani dy macet të ndara derisa të mësohen me njëra-tjetrën.
- ❗ Sigurohuni që secila prej tyre të ketë kutinë e vet të rërës - një kuti e 3-të është edhe më e mirë.
- ❗ Vendosni enë ushqimi dhe uji për çdo mace larg njëra - tjetrës.
- ❗ Përdorni lodra për t'i ndihmuar ato të bashkëveprojnë dhe të luajnë së bashku.



## PREZANTIMI MACE ME QEN

- ❗ Së pari, krijoni një hapësirë të sigurt për macen tuaj. Sigurohuni që macja të ketë një vend të sigurt për t'u tërhequr dhe vendosni ushqimin, ujin dhe rërën e saj diku që nuk janë të arritshme për qenin.
- ❗ Para se ta sillni qenin tuaj të ri në shtëpi, beni një shëtitje të gjatë dhe ushqejeni mirë në mënyrë që ata të jenë sa më të qetë gjatë prezantimit.
- ❗ Mbajeni qenin tuaj të lidhur, por lërinë macen të lëvizë lirshëm. Instinkti i parë i maces mund të jetë të fërshëllejë, të vrapojë e të fshihet dhe kjo është plotësisht normale.
- ❗ Nëse macja juaj bëhet kurioze për të sapoardhurin dhe përpiqet ta nuhasë, ky është një tregues i mirë se ata mund të bëhen shokë të shkëlqyeshëm.



## PREZANTIMI QEN ME QEN

Ndërveprimet e qenve janë gjithmonë të paparashikueshme.

- ❖ Mundohuni të prezantoni qentë me njëri-tjetrin në një territor neutral, si një park ose një vend tjetër jashtë shtëpisë.
- ❖ Shmangni udhëtimin me të dy qentë në të njëjtin automjet.
- ❖ Merrni një ndihmës për të mbajtur qenin e ri dhe mbajini të dy të lidhur gjatë prezantimit.
- ❖ Kur të mbërrini të gjithë në shtëpi, merrni të dy qentë për një shëtitje së bashku rreth lagjes para se të hyni brenda.
- ❖ Mbajini dy qentë të ndarë sa herë që nuk ndodheni në shtëpi, derisa ata të mësohen me njëri-tjetrin.



## PREZANTIMI QEN ME KËLYSH

- ❖ Nëse planifikoni të adoptoni një këlysh, lëreni të qëndrojnë me nënën e tij sa më gjatë që të jetë e mundur. Këlyshët mësojnë sjelljet e mira themelore dhe si të komunikojnë me qentë e tjerë nga nënat e tyre.
- ❖ Qentë e moshuar mund të jenë të padurueshëm me këlyshët e rinj.
- ❖ Sa më shumë këlyshët të mësojnë rregullat e lojës dhe të sjelljes së qenve, aq më mirë do të shoqërohen me qentë e rritur.
- ❖ Mos e qortoni qenin tuaj nëse vërshon tek këlyshi. Lehjet janë një formë komunikimi dhe qeni më i vjetër po i mëson qenushit se si të respektojë kufijtë.

## PREZANTIMI QEN ME MACE

- ❖ Qentë duhet të jenë gjithmonë të lidhur kur takohen me mace.

- ❗ Kushtojini vëmendje gjuhës së trupit të të dy kafshëve dhe shikoni për shenjat paralajmëruese.
- ❗ Kurioziteti i ndërsjellë është treguesi më i mirë se të dy do të shkojnë mirë.
- ❗ Nëse qeni juaj duket i qetë kur takohet me një mace dhe do t'u bindet komandave “ulu” dhe “qëndro” ndërsa macja sillet lirshëm në shtëpi, nuk ka gjasa që qeni juaj të sillet në mënyrë agresive ndaj maces në të ardhmen.
- ❗ Sidoqoftë, nëse qeni juaj fiksohet duke vështruar macen, hidhet në drejtim të saj ose gërvisht në dyer kur macja është në një dhomë tjetër, këto nuk janë shenja të mira.



## KUJDESI NDAJ KOTELEVE

Kotelet e shkëputura nga nëna e kanë shumë të vështirë të mbijetojnë pa të pasi nuk mund të ushqehen dot vetë. Katër janë aspektet kryesore që ndikojnë në mbijetesën e tyre.

### NGROHTËSIA/TEMPERATURA E TRUPIT

Temperatura normale e trupit të maceve është 38°C. Mirëpo ato nuk janë në gjendje ta krijojnë vetë këtë ngrohtësi. Është nëna ajo që i ngroh duke i mbajtur afër. Në mungesë të saj, duhet t'i vendosni një shishe, ose borsë me ujë të nxehtë në ndonjë shportë ose kuti.

Mbulojeni shishen/borsën me një copë dhe vendosini kotelet afër. Kjo do i ndihmojë të ruajnë temperaturën trupore. Duhet ta rimbushni shishen/borsën me ujë të nxehtë sa herë të ftohet.

Mos e ushqeni një kotele pa e ngrohur qumështin, pasi nuk mund ta tretë siç duhet ushqimin kur është e ftohtë.

### USHQYERJA


Në mungesë të qumështit pluhur për kotele, ushqimi më i mirë dhe i tretshëm për ta, është qumështi i dhisë. Ai mund të blihet tek Spar ose Conad. Qumështi i lopës nuk është i ushqyeshëm për kotele dhe mund t'u shkaktojë diarre, e cila është jashtëzakonisht e rrezikshme për to.

Qumështin ia ngrohni përpara, e holloni me pak ujë në një filxhan dhe e mbushni shiringën ose biberonin për kotele me të. Me pas ia vendosni në anësore të gojës grykën e shiringës dhe i ushqeni ngadalë, që të mos mbyten duke u kapërdirë. Në rastin e biberonit, mund t'ia jepni drejt (pra jo në anësore).



Sigurohuni që rredhja e qumështin mos të jetë shumë e shpejtë. Kur rrjedhja është shumë e shpejtë, kjo mund të çojë në aspiratë, pneumoni dhe / ose vdekje. Kur e ushqeni, mbajeni kotelen në një pozicion horizontal, me 4 këmbët e mbështetura në tokë (*shihni imazhet*).

I jepni të pijnë rreth 2-5 ml në varësi të oreksit të tyre. Me pas i vendosni prapë te kutia. I ushqeni kështu çdo 2-3 orë.



## SASIA E USHQYRJES NDËR JAVË

Kotelet një javëshe duhet të ushqehen çdo 2 - 3 orë, 2 deri në 5 ml. Në moshën dy javëshe, ato mund të ushqehen çdo 4 - 6 orë, 7 deri në 10ml. Pas tre javësh dhe derisa të hiqen nga qumështi, kotelet duhet të ushqehen çdo 6 - 8 orë, rreth 12-20 ml.

Pas 4 javësh mund te fillohet shtesa ushqimore, pa e ndërprerë qumështin.

Këshillohet gjoks pule, të cilin e zieni dhe e bluani në një mikser/frulator, në mënyrë që të bëhet kremoz dhe të përzieret me një lugë kafe qumësht. I ushqeni kështu të paktën dy vakte në ditë javën e parë. Në mungesë të gjoksit të pulës mund të blini ushqim Plasmon për bebe me mish pule pasi tretet më lehtë. Mbase mbushin 6-7 javë mund të fillojmë lloje të tjera të ushqimit si p.sh. konserva dhe kokrra per kotele.

## STIMULIMI I URINIMIT DHE JASHTËQITJES

Kotelet nuk mund të urinojnë ose defekojnë vetë deri në moshën 3 javëshe. Pas ushqimit, ju duhet të stimuloni refleksin e tyre për të kryer nevojat duke ledhatuar butësisht zonën e gjenitaleve me një pambuk (ose një leckë të butë) të lagur me ujë të ngrohtë (*shihni imazhin*).



## MACET DHE RËRA

Ndiqni këto hapa për të mesuar një mace të kryejë nevojat tek rëra:

- ❖ Tregojini kutinë e rërës duke e vendosur macen në të dhe duke e lënë atë ta nuhasi dhe ta ekzaminojë. Sigurohuni që të mos i lëvizni kutinë pasi t'ia keni treguar, në mënyrë që të mos ngatërmoni macen.
- ❖ Vendoseni macen tuaj në kutinë menjëherë pas ushqyrjes dhe pasi të zgjohtn nga gjumi.
- ❖ Nëse vëreni se sillet sikur do të ikë, po nuhat ose përkulet në një zonë të caktuar, merreni dhe vendoseni në kutinë e rërës.
- ❖ Shpërblejeni sa herë që vini re se po e përdor rërën. Përkëdheleni macen dhe jepini një qerasje ose një lodër.
- ❖ Mos e ndëshkoni ose qortoni macen tuaj nëse ndodh të mos i kryejë nevojat te rëra. Kjo do ta bëjë macen me stres dhe ankth, të cilët mund të përkeqësojnë problemin dhe ta bëjnë mësimin më të vështirë.



## KUJDESI NDAJ KËLYSHËVE

Për të ndihmuar në shpëtimin e këlyshëve pa nënë, do t'ju duhet të merrni rolin e qenit nënë. Do t'ju duhet t'i ushqeni këlyshët shpesh gjatë gjithë ditës. Pa praninë e nënës së tyre, këlyshët jetimë janë të ndjeshëm ndaj dehidrimit, hipoglicemisë, hipotermisë dhe problemeve të tjera mjekësore.

Edhe pse dy deri në tre javët e para mund të jenë të vështira, përpjekja do t'ia vlejë pasi këlyshët do rriten të bëhen qen të shëndetshëm.



### NGROHTËSIA/TEMPERATURA E TRUPIT

Sigurohuni që këlyshët jetimë të qëndrojnë ngrohtë në këtë moshë delikate - një shishe ose borsë me ujë të ngrohtë e mbështjellur me një peshqir/batanije, do të ndihmojë.



### SASIA E USHQYERJES NDËR JAVË

Këlyshët do të duhet të ushqehen me një zëvendësues komercial të qumështit të qenit. Sigurohuni që të përdorni një të formuluar posaçërisht për këlyshë, pasi qumështi i lopës dhe zëvendësues të tjerë mund të shkaktojnë diarre. Në kushtet kur nuk keni qumësht komercial, mund të përdorni qumështin e dhisë të holluar me pak ujë.

Këlyshët zakonisht ushqehen të paktën çdo 2 orë në javën e tyre të parë të jetës. Ndërsa zhvillohen dhe rriten, intervalet midis ushqimit rriten. Në moshën rreth katër javëshe,



këlyshët mund të fillojnë të kalojnë nga qumështi në ushqim me të fortë. Kur bëni kalimin në ushqim të ngurtë, kokrrat mund të ngjyhen në ujë të ngrohtë ose zëvendësues qumështi dhe të përzihen derisa ushqimi të ketë trashësinë e qullit. Kjo mund të bëhet disa herë në ditë.

## STIMULIMI I URINIMIT DHE JASHTËQITJES

Këlyshët nuk mund të defekojnë ose urinojnë vetë në fillim. Do t'ju duhet t'i ndihmoni duke i masazhuar para ose pas çdo vakti. Ju mund të përdorni një top pambuku ose një leckë të lagur me ujë të ngrohtë. Fërkojini butësisht rreth anusit dhe organeve gjenitale derisa të defekojnë dhe të urinojnë.




## SI TË MËSOJMË QENTË TË KRYEJNË NEVOJAT JASHTË

Trajnimi i qenit tuaj kërkon durim, përkushtim dhe shumë qëndrueshmëri. Incidentet e vogla janë pjesë e procesit.

Fillimisht, do t'ju duhet të ndërtoni një rutinë rreth nevojave të qenushit tuaj, dhe këto janë me siguri të parashikueshme kur ai është i vogël.

- 🐾 Këlyshët duhet të urinojnë menjëherë pasi zgjohen, kështu që ju duhet të jeni aty për ta nxjerrë qenushin jashtë pa asnjë vonesë.
- 🐾 Ngrënia e vakteve ushqimore stimulon sistemin e tij tretës. Këlyshët normalisht urinojnë brenda pesëmbëdhjetë minutave pas ngrënies dhe defekojnë brenda gjysmë ore pas ngrënies (edhe pse kjo mund të ndryshojë pak nga njëri këlysh në tjetrin).
- 🐾 Këlyshët kanë kontroll shumë të dobët të fshikëzës dhe kanë nevojë të urinojnë të paktën çdo 1-2 orë. Ata mund të urinojnë spontanisht kur emocionohen, kështu që nxirreni qenushin tuaj shpesh jashtë nëse ka qenë aktiv, duke luajtur ose duke eksploruar.
- 🐾 Zakonisht, një qenush mund të kontrollojë urinimin një orë për çdo muaj të moshës. Pra, nëse qenushi juaj është 2 muajsh, ai mund ta mbajë atë për rreth dy orë.



Shpërblejeni qenushin tuaj sa herë që kryen nevojat jashtë. Lavdërojeni ose jepini qerasje - por mos harroni ta bëni këtë menjëherë pasi të kenë mbaruar, jo pasi të

ktheheni në shtëpi. Ky hap është jetik, sepse shpërblimi i qenit tuaj për daljen jashtë, është mënyra e vetme për të mësuar se çfarë pritet prej tij.

**Qentë duhet të dalin jashtë PAS këtyre momenteve kryesore:**

- Pas dremitjeve ose gjumit, për çdo periudhë kohe më të gjatë se 15 minuta
- Pas ngrënies
- Pas pirjes
- Pas një seance loje
- Pas një seance stërvitore
- Pas një ngjarjeje stresuese ose të frikshme

**Qentë duhet të dalin jashtë PARA këtyre momenteve kryesore:**

- Para se të shkoni në shtrat gjatë natës (jo më shumë se 10 minuta para gjumit!)
- Përpara se të futen në rrethim
- Përpara një seance stërvitore
- Përpara se të vijë për një vizitë miq ose familjarë
- Para se të hyjnë në klinikë veterinare

**VINI RE!** Pronarët të kafshëve të shoqërimit kanë për detyrë të shmangin ndotjen e vendeve publike nga kafshët, si dhe të pastrojnë vendin pas defekimit, në rast ndotjeje. (LIGJ Nr.10 465, datë 29.9.2011 PËR SHËRBIMIN VETERINAR, Seksioni 3, Neni 73, Pika 3/e)



## RËNDËSIA E AKTIVITETIT FIZIK PËR QENTË

Ushtrimet dhe aktiviteti fizik janë thelbësore për të gjithë qentë. Ndhimjnë jo vetëm në mbajtjen e tyre në formë, por janë shume të rëndësishme edhe për shëndetin e tyre mendor. Shëtitjet e përditshme i mbajnë ata të lumtur dhe të shëndetshëm.

Mungesa e ushtrimit mund të shkaktojë probleme shëndetësore, siç është mbipesha, por mund të krijojë dhe probleme në sjellje. Qentë e mërzitur janë qen të palumtur dhe ata mund të tregojnë zhgënjimin e tyre duke kafshuar, lehur shumë, bërë nevojat në shtëpi dhe duke u lëpirë me tepri.

Ndryshe nga qentë që jetojnë në shtëpi me oborr, nëse vendosni të mbani një qen në apartament, do të jetë edhe më e rëndësishme ta shëtisni të paktën 2 ose 3 herë në ditë. Kjo nuk do të thotë që nëse keni një oborr nuk duhet të shëtisni qenin. Thjesht nëse qeni është gjithmonë brenda shtëpisë shëtitja, është e domosdoshme.



## PËR KËLYSHËT

Këlyshët janë plot jetë dhe kanë nevojë për stërvitje për të qëndruar të shëndetshëm, por shumë ushtrime mund të jenë të dëmshme për kockat dhe ligamentet e tyre në zhvillim.

Si rregull i përgjithshëm, synoni të shëtisni qenushin tuaj 5 minuta për çdo muaj moshe, 2 herë në ditë (p.sh. tre muajsh = 15 minuta dy herë në ditë, katër muajsh = 20 minuta dy herë në ditë, etj.).

Nëse ata duken sikur po lodhen dhe mundohen tepër, shkurtoni shëtitjet derisa të përmirësohet aftësia e tyre



(dhe konsultohuni me veterinerin nëse nuk përmirësohen). Nëse ata ende kanë energji gjatë gjithë kohës, mbase një shëtitje tjetër do ishte e nevojshme.

Nëse këlyshi juaj shtrihet gjatë një shëtitjeje, kjo tregon se ata kanë nevojë për një pushim. Ndaluni për pak kohë derisa ata të jenë gati të ecin përsëri.

## PËR QENTË E RRITUR

### RACAT TRUPMËDHA

Shumica e racave të mëdha, janë të forta dhe kanë qëndrueshmëri të mirë nëse janë në formë. Disa raca më të mëdha kanë nevojë për shëtitje relativisht të shkurtër krahasuar me racat e tjera të mëdha. Ata e harxhojnë energjinë e tyre në shpërthime të shkurtra, kështu që mirë është të fillohet me një vrapim 20 minutësh, pastaj të ecin më vonë.

Koha dhe distanca do të varen nga shëndeti aktual i qenit tuaj, por ecja është ushtrim i shkëlqyeshëm për racat më të mëdha.



### RACAT TRUPMESATARE

Qentë trupmesatarë mund të vijnë në shumë forma dhe madhësi, por të gjithë duhet të kenë qëndrueshmëri të mirë për sa kohë që janë të shëndetshëm.

Racat trupmesatare do të duan të bëjnë shëtitje të gjata. Disa raca trupmesatare do të duan të vrapojnë me ju.

Nëse qeni juaj është adhurues i ujit, noti është ushtrim i shkëlqyeshëm. Nëse jeni me fat të jetoni pranë detit ose të njihni ndonjë vend lokal ku mund ta çoni qenin për të notuar, është stërvitje e shkëlqyeshme pasi nuk u jep shumë mundim ligamenteve të tyre.

### RACAT TRUPVOGLA

Racat trupvogla të qenve shpesh nuk do të kenë nevojë për aq shumë ushtrime sa ato më të mëdha, por ka disa përjashtime nga rregulli. Shumica e racave më të vogla janë në

rregull deri në një orë stërvitje në ditë, por mund të kenë nevojë për më shumë në varësi të qëndrueshmërisë së tyre.

## PËR QENTË E MOSHUAR

Qentë e moshuar kanë më shumë gjasa të kenë probleme shëndetësore që mund të kufizojnë shëtitjet e tyre. Ata priren të ngadalësojnë pak ose të pushojnë më shumë, por është e rëndësishme t'i mbani aktivë në mënyrë që të qëndrojnë të shëndetshëm.

Shëtitjet e tyre duhet të jenë të rregullta dhe të lehta. Kjo do ta mbajë qenin tuaj të moshuar aktiv dhe do të ndihmojë muskujt dhe ligamentet e tyre. Mos i nxitoni ose mos u përpiqni t'i bëni të shëtisin më gjatë sesa ata janë në gjendje të ecin. Nëse ata ndalojnë së ndjekuri një lodër ose shtrihen në një shëtitje, ata duhet të pushojnë.



**Kini kujdes motin!** Qentë e moshuar nuk përballen aq mirë me temperaturat shumë të larta ose të ulëta. Nëse moti është shumë i nxehtë ose i ftohtë jashtë, është një ide e mirë të bëni disa seanca ushtrimesh brenda derisa moti të jetë më i përshtatshëm për ta.

**KUJDES!** Nëse vini re se qeni juaj ka ndonjë problem me lëvizjen ose nuk duket se e shijon më idenë e shëtitjeve, drejtohuni tek veterineri pasi mund të ketë gjëra që mund të përmirësojnë cilësinë e jetës së tij dhe të lehtësojnë dhimbjet që e pengojnë atë ta shijojë lëvizjen.

## RËNDËSIA E AKTIVITETIT FIZIK PËR MACET

Të gjithë e dimë se maceve u pëlqen të flenë, por ushtrimet e përditshme janë gjithashtu shumë të rëndësishme për t'i mbajtur ato të lumtura dhe të shëndetshme. Qëndrimi në formë dhe aktive do të zvogëlojë mundësinë e maces tuaj për të zhvilluar probleme shëndetësore të tilla si diabeti, obeziteti dhe artriti. Ushtrimi është gjithashtu i rëndësishëm për shëndetin mendor të maces tuaj, parandalon mërzitjen dhe i lejon ato të shprehin sjelljen natyrale.



Janë të këshillueshme dy seanca 15-20 minuta çdo ditë, të cilat mund t'i zgjasni tek sa bëhen më në formë dhe më entuziaste. Sigurohuni që seancat e lojës të jenë të shkurtra dhe gjithmonë u jepni atyre kohë të mjaftueshme për të pushuar në mes. Asnjëherë mos e detyroni macen tuaj të bëjë diçka që nuk dëshiron.

Është veçanërisht e rëndësishme të inkurajoni macet që qendrojnë vetëm në ambiente të mbyllura, që të bëjnë shumë ushtrime, pasi ato nuk djegin aq shumë energji.

### LODRAT

Ka shumë lodra që mund t'i bleni për macet, madje ka edhe disa që mund t'i bëni në shtëpi.


**Topa:** Macet kënaqen duke goditur diçka që lëviz lehtësisht nëpër dysheme, si për shembull një top - thjesht sigurohuni që të jetë i sigurt për macen dhe që ata të mos mund ta përtypin ose ta gëlltisnin.

**Lodrat e gjuetisë:** lodrat me erë ose një lodër e zvarritur nëpër dysheme do t'i kthejë edhe macet më dembele në gjahtarë.

**Lodrat ngacmuese:** Lodrat ngacmuese janë lodrat ideale për macet - atyre u pëlqen t'i ndjekin dhe të kërcejnë për to ndërsa tërhiqen zvarrë përgjatë dyshemesë dhe lëvizin në ajër. Vetëm mos harroni ta lini macen tuaj ta kapë lodrën rregullisht në mënyrë që të mos zhgënjehet

**Ngjitja dhe fshehja:** Maceve u pëlqen të ngjiten lart dhe të fshihen, dhe mund të argëtohen me orë të tëra në një pemë maceje (cat tree), një kuti të thjeshtë kartoni ose një tunel. Jo vetëm që i inkurajon ato të luajnë, por gjithashtu u siguron atyre një hapësirë të tyre.

**Gërvishtja:** Shtyllat gërvishtëse janë thelbësore nëse zotëroni një mace. Ato e lejojnë macen tuaj të shprehë sjelljen e saj normale të gërvishtjes, t'i mbajë kthetrat të rregullta, të tonifikojë muskujt dhe gjithashtu do të ndihmojë në ruajtjen e mobiljeve tuaja!



## BIMË HELMUESE PËR KAFSHËT SHTËPIAKE

Disa bimë janë krejtësisht të sigurta për kafshët shtëpiake, ndërsa disa tjera mund të shkaktojnë vetëm një shqetësim të lehtë të barkut. Megjithatë, shumë prej tyre mund të jenë shumë toksike apo edhe kërcënuese për jetën. Jo të gjitha kafshët shtëpiake preken në të njëjtën mënyrë nga bimët helmuese. Një bimë mund të prekë një kafshë shtëpiake shumë seriozisht, por të mos shkaktojë simptoma tek të tjerët. Për të mbajtur kafshën tuaj të sigurt, është më mirë të shmangni plotësisht bimët helmuese, pavarësisht se sa toksike janë ato.



Ekzistojnë gjithashtu disa bimë në veçanti që mund të jenë shumë toksike, apo edhe kërcënuese për jetën. Për shumë bimë, sasia që ha kafsha juaj është e rëndësishme. Sa më shumë që kafsha juaj të gëlltisë, aq më shumë ka gjasa që të jetë toksike. Megjithatë, për disa bimë shumë toksike, edhe një sasi e vogël mund të shkaktojë probleme. Nëse kafsha juaj ha një bimë që ju nuk e njihni, është e rëndësishme t'i monitoroni ato për simptoma dhe të flisni me veterinerin tuaj nëse jeni të shqetësuar.

### BIMËT SHUMË TOKSIKE

**Zambakët** te macet: Të gjitha pjesët e zambakut mund të jenë shumë toksike për macet dhe mund të çojnë në dëmtim të veshkave, të cilat fatkeqësisht mund të jenë fatale. Nëse mendoni se macja juaj mund të ketë lëpirë ose ka ngrënë një zambak - duke përfshirë nëse macja juaj ka lëpirë qimet e saj pasi ka qenë në kontakt me polenin e zambakut, është thelbësore të kontaktoni menjëherë veterinerin tuaj për ndihmë.

**Kërpudhat:** Ka shumë lloje kërpudhash dhe vetëm disa janë toksike. Shumë lloje do të shkaktojnë diarre dhe të vjella, por disa mund të çojnë në probleme serioze ose fatale,

të tilla si aritmi (ritme jonormale të zemrës), kriza ose dështim të organeve. Duke qenë se identifikimi i llojeve të ndryshme të kërpudhave mund të jetë i vështirë, është më mirë t'i shmangni ato plotësisht për t'u siguruar që kafsha juaj të mos hajë aksidentalisht një varietet toksik.

**Lulja 1000 fletëshe:** Kjo bimë mund të shkaktojë probleme serioze si te kafshët shtëpiake ashtu edhe te njerëzit. Kërçelli dhe gjethet e bimës përmbajnë toksina që mund të çojnë në djegie dhe flluska të lëkurës.

Edhe pse kafshët shtëpiake shpesh kanë njëfarë mbrojtjeje nga gëzofi i tyre, zonat pa qime ose me gëzof të hollë (si veshët, goja dhe barku) mund të preken. Nëse lëngu lëpohet nga gëzofi ose shkon në sy, mund të shkaktojë edhe më shumë dëme. Është e rëndësishme të kontaktoni veterinerin tuaj nëse mendoni se kafsha juaj ka rënë në kontakt me këtë bimë.

Nëse jeni të shqetësuar për veten ose dikë që njihni, kontaktoni mjekun tuaj për ndihmë.




*Të tjera bimë që duhen shmangur janë: barbaroza, ashe, gështenja e kalit, zymbyli, shpatoret, gladiola, dredhka, dafina, veshtulli, lisi, bimët e qepëve dhe hudhrave (të gjitha pjesët e bimës), raveni, vadha, lulebora, tulipani, bërsheni.*

## SHKALLA E AGRESIONIT TE QENTË

Kafshimi për qentë është si grushtimi për njerëzit, opsioni i fundit për t'u përballur me një situatë të pakëndshme.

Por, duke njohur dhe kuptuar sjelljet që i paraprijnë kafshimit, ne mund të parandalojmë që qeni të vihen në situata të vështira.

Reagimet e qenve ndaj stresit ose një kërcënimi, mund të shihen si një seri hapash në ngjitje në një shkallë.



©Kendal Shepherd 2004

Kjo shkallë është një ndihmë jashtëzakonisht e dobishme për të mësuar shenjat që një qen shfaq para se të arrijë fazën e kafshimit.

Qentë zakonisht do të përdorin të gjitha këto sinjalet e shkallës së agresionit ndaj nesh, qenve, edhe ndaj specieve të tjera.

Shumica e qenve nuk janë natyrshëm agresivë. Është e rëndësishme që të kuptojmë se si qentë tanë komunikojnë, në mënyrë që të shmangim vendosjen e tyre në situata ku ata ndjejnë se kafshimi mund të jetë opsioni i tyre i vetëm.

Kjo do të sjellë një marrëdhënie të mirë me qentë tanë dhe shpresojmë të zvogëlojë numrin e kafshimeve.

## QENTË NUK MBAHEN TË LIDHUR!

Është e rëndësishme që njerëzit që lidhin qentë të kuptojnë rreziqet e këtij veprimi.

Qentë janë qenie natyrale shoqërore që kanë nevojë për ndërveprim me njerëz dhe/ ose kafshë të tjera. Lidhja për një kohë të gjatë ose mbajtja në izolim, mund të dëmtojë rëndë mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike. Një qen miqësor dhe i bindur, kur mbahet vazhdimisht i lidhur me zinxhirë ose i mbyllur intensivisht në ndonjë mënyrë, bëhet nevrik, i palumtur, i shqetësuar dhe shpesh agresiv.

Ndodh rëndom që qentë e lidhur të pësojnë sëmundje fizike. Qafa e tyre mund të rrjepet dhe lëndohet nga litari. Ata janë të prekshëm nga pickimet e insekteve dhe parazitët.

Me rrezik të lartë është dhe asfiksioni nga ngatërimi i mundshëm i litarit.

Lidhja nuk është e keqe vetëm për qentë por edhe për njerëzit, pasi është një faktor me rrezik të lartë për kafshimet dhe sulmet serioze nga qentë. Qentë e paaftë të tërhiqen nga kërcënimet e perceptuara ose reale mund të veprojnë në mënyrë agresive kur dikush u afrohet.

Qentë ndjehen natyrshëm mbrojtës të territorit të tyre dhe kur përballen me një kërcënim të perceptuar, ata përgjigjen sipas instinktit të tyre të luftës ose të ikjes. Një qen i lidhur, i paaftë për të ikur, zgjedh për të luftuar, duke sulmuar çdo kafshë ose person të panjohur që padashur endet në territorin e tij.



## KAFSHËT DHE FISHEKZJARRET

Zhurmat e forta, të papritura dhe dritat shpërthyesë si fishekzjarret, mund të jenë shumë të frikshme për kafshët shtëpiake, bagëtitë dhe zogjtë.

Macet dhe qentë kanë një sens dëgjimi shumë të zhvilluar, shumë më të rafinuar se ai i qenieve njerëzore. Çdo zhurmë që ne dëgjojmë, ata e dëgjojnë 4 herë më fort.



© www.dentonafs.com

### SI T'I MBANI TË SIGURTA KAFSHËT SHTËPIAKE GJATË FISHEKZJARREVE

Mbani kafshët tuaja të sigurta gjatë fishekzjarreve duke ndjekur këshillat e mëposhtme. Nëse nuk i ruani, ata rrezikojnë të traumatizohen ose të ikin nga shtëpia.

- ❗ Sigurohuni që qeni ose macja juaj të ketë gjithmonë një vend për t'u fshehur nëse dëshiron dhe të ketë akses në këtë vend në çdo kohë. Për shembull, nën mobilje ose në një dollap.
- ❗ Sigurohuni që macja ose qeni juaj të mbahen gjithmonë në një mjedis të kontrolluar dhe të sigurt dhe nuk mund të ikin nëse ndodh një zhurmë e papritur.
- ❗ Kur ka të ngjarë të përdoren fishekzjarre shëtisni qentë gjatë orëve të ditës, dhe mbani macet dhe qentë në ambiente të mbyllura.
- ❗ Në mbrëmje, mbyllni dritaret dhe perdet dhe vendosni muzikë për të maskuar zhurmën e fishekzjarreve.
- ❗ Asnjëherë mos i ndëshkoni kafshët tuaja kur janë të frikësuar pasi kjo vetëm do t'i përkeqësojë gjërat.
- ❗ Nëse mundeni, qëndroni në shtëpi. Thjeshtë prania juaj mund të jetë ngushëllimi më i mirë.

## SI TË KUJDESENI PËR KAFSHËT ENDACAKE GJATË MOTIT TË NXEHTË

Ne verë asfalti mund të nxehet aq shumë sa mund të djegë putrat e një qeni. Temperaturat e larta mund të shkaktojnë stres dhe dëmtime fizike, përfshirë dëmtimin e trurit dhe madje mund të rezultojë në vdekjen e kafshëve.

### Ofroni ujë, jo vetëm ushqim

Është më mirë të përdorni tasa qelqi për ujë pasi e mbajnë më të freskët. Sigurohuni që rregullisht të pastroni dhe ndryshoni ujin për të shmangur infeksionet që vijnë nga ai.

### Kontrolloni nën makina

Kontrolloni nën automjetin tuaj para se ta ndizni. Qentë dhe macet shpesh futen nën hijen e makinave. Ndërsa disa prej tyre mund të dallojnë tingullin e ndezjes së një makine, të tjerët mund të mos e njohin atë ose mund të jenë në gjumë të thellë.

### Ofroni një strehë të improvizuar

Pragjet e dyerve mund të jenë vendet ideale për të lejuar një qen ose dy të strehohen përkohësisht nga nxehtësia. Ju mund të lini një tas me ujë dhe të vendosni diçka që mund të krijojë hije.



## SI TË KUJDESENI PËR KAFSHËT ENDACAKE GJATË MOTIT TË FTOHTË

### Goditni kofanon e makinës para se ta ndizni

Shumë kafshë kërkojnë ngrohtësi dhe strehim nën makinë kur moti bëhet i ftohtë. Trokitni 2-3 herë mbi kofano, në mënyrë që ata të largohen. Një gjest kaq i thjeshtë mund t'ua shpëtojë jetën.



### Siguroni një strehim

Nëse jeni të gatshëm dhe nëse kafsha dëshiron, ftojeni brenda shtëpisë ose garazhit tuaj kur moti është i keq. Ju këshillojmë t'i vizitoni te një veteriner për të parë mos kanë mikrochip, dhe për t'u siguruar për shëndetin e tyre.



### Ndërtoni një strehë

Nëse shihni se një kafshë endacake nuk dëshiron të hyjë brenda, prapë mund t'i ndihmoni. Krijimi i një strehe të përkohshme zgjat rreth 10 minuta dhe siguron mbrojtje dhe ngrohtësi nga moti i ftohtë.


### Ofroni ushqim dhe ujë

Është një gjest i përzemërt t'i ofroni ujë dhe ushqim një kafshe endacake në zonën tuaj. Kujdes që tasat me ujë dhe ushqim mos të ngrijnë kur temperaturat janë minus.

## MACE E HUMBUR APO ENDACAKE?


Nëse keni gjetur një mace, por nuk jeni të sigurt nëse ka pronar apo jo, ndiqni hapat e mëposhtëm për t' u siguruar që nuk është e humbur ose endacake.

- 🐾 Në një copë letër shkruani "Nëse kjo është macja juaj, ju lutemi telefononi këtë nr...".
- 🐾 Lidhni letren rreth qafës së maces me pak ngjitëse të tejdukshme. Sigurohuni që midis qafës prej letre dhe qafës së maces të ketë 2 gishta hapësirë.
- 🐾 Nëse askush nuk telefonon brenda pak ditësh, macja mund të jetë e humbur ose endacake.
- 🐾 Ju këshillojmë t'i shkruani organizatave për mbrojtjen e kafshëve që ta publikojnë në mënyrë që t'i gjendet i zoti ose dikush që dëshiron ta adoptojë.



## MIRËMBAJTJA E LPUJVE

Nuk ka ndonjë mënyrë të përsosur për t'u kujdesur për të gjithë lepujt, sepse çdo lepur dhe situatë është e ndryshme, por ne kemi përgatitur një udhëzues gjithëpërfshirës për t'ju ofruar bazat e kujdesit për kafshën tuaj.



### DIETA

Lepujt kanë nevojë për shumë fibra të cilësisë së lartë për të mbajtur dhëmbët (të cilët vazhdojnë të rriten gjatë gjithë jetës së tyre) dhe sistemin tretës të shëndetshëm. Ushqyerja e lepurit tuaj me ushqimin ose sasinë e gabuar mund të rezultojë në probleme urinare dhe dentare.

Një mënyrë e shkëlqyer për të kontrolluar se po e ushqeni saktë lepurin tuaj, është duke kontrolluar jashtëqitjet e tyre, ato duhet të jenë të mëdha dhe të duken si sanë e ngjeshur.

### SANA DHE BARI

Lepujt kanë nevojë për qasje të pakufizuar në sanë, pasi produktet me bazë bari duhet të përbëjnë rreth 80% të dietës së tyre. Kjo do të thotë bar i freskët dhe i tharë, sanë livadhore dhe silazhimi.



### PERIMET

Lepujt mund të kenë një sasi të vogël perimesh çdo ditë, që përbëjnë rreth 15% të dietës së tyre. Kjo jo vetëm që i siguron lepurit tuaj lëndë ushqyese dhe vitamina të tjera, por gjithashtu u jep atyre shije të ndryshme. Sigurohuni që t'i lani mirë të gjitha perimet përpara se ta ushqeni lepurin tuaj.

Perimet e sigurta për lepujt përfshijnë: borzilok, brokoli, karota, gjethet e selinos, kungull i njomë, bishtaja, majdanoz, panxhar, spinaq, kopër.

## PELETAT

Peletat (drithëra të veçanta për lepuj) mund të ofrohen për të plotësuar ushqimin e lepurit tuaj dhe për t'u siguruar që po ushqehen me një dietë të ekuilibruar. Kjo duhet të jetë vetëm 5% të dietës së tyre (një lugë gjellë). Zgjidhni peleta me cilësi të lartë në vend të ushqimeve të stilit muesli. Muesli inkurajon ushqyerjen selektive dhe lepurit juaj mund të mos marrë të gjitha lëndët ushqyese që i nevojiten.



## QERASJET

Nëse dëshironi t'u jepni lepujve tuaj diçka të veçantë, ju rekomandojmë perime të freskëta, bimë, barishte ose një sasi shumë të vogël frutash. Qerasjet e sigurta për lepujt përfshijnë: kungull, molla (jo farat, ato janë helmuese), banane, kivi, pjepër, dardhë, kumbulla, luleshtrydhe. (Këto duhet të jepen në sasi shumë të vogla dhe të shmangen për lepujt mbipeshë).

*Ju duhet të shmangni nga ushqyerja: fier, lule margarita, hudhra, presh, gjethet e lisit, qepë, patate, qiçra, voshtër, farat (frutash, bishtajore dhe drithëra), ushqim për mace ose qen, mish, djathë, produkte qumështi, fruta të konservuara, kripë, sheqer, çokollatë.*

## UJI

Lepujt kanë nevojë për qasje në ujë të freskët në çdo kohë. Sigurohuni që të ndryshoni ujin e tyre çdo ditë dhe të pastroni rregullisht tasat.

## SHËNDETI

Përveç kontrolleve të rregullta shëndetësore, lepurt duhet të vaksinohen kundër dy sëmundjeve të rënda dhe fatale: Miksomatozës dhe Sëmundjes Hemorragjike Virale sapo të mbushin moshën pesë javëshe. Gjithashtu duhet t'u jepen vakcina përforcuese vjetore.

## AKTIVITETI FIZIK I LEPURIT

Lepuri është një gjitar që bën shumë aktivitete fizike kur është në natyrë. Prandaj, është shumë e rëndësishme ta lëmë lepurin tonë të lirë nga kafazi të paktën dy herë në ditë, padyshim duke e kontrolluar dhe mbajtur larg rreziqeve të mundshme.



Diçka tjetër që mund të bëjmë, është të krijojmë një shteg për të me

objekte që mund t'i blejmë në një dyqan kafshësh ose që mund t'i krijojmë në shtëpi. Gjithashtu, është e rëndësishme të kaloni kohë me të duke i ofruar përkëdhelje dhe vëmendje.

Mos harroni se lepurit është një kafshë inteligjente që mund të mësojë urdhra nëse keni kohë dhe durim të merreni me të.

Në dyqane të specializuara mund të blini mjete për ta çuar në shëtitje, për shembull në një livadh ose në një pyll. Marrja e tij jashtë është thelbësore për t'u siguruar që ai të rizbulojë aromën e natyrës. Sigurisht, duhet të keni kujdes që mos t'ju ikë.

**KUJDES:** Lepurit shtëpiakë nuk mund të mbijetojnë të vetëm në natyrë. Nëse nuk mund ta mbani më lepurin tuaj, duhet të kërkonit një familje tjetër për të.

## STERILIZIMI

Sterilizimi i lepurit ka një sërë përfitimesh të mëdha përveç parandalimit të shtatzanisë. Lepujt meshkuj zakonisht sillen më mirë kur sterilizohen, me më pak sjellje agresive ndaj lepujve dhe njerëzve të tjerë. Një pjesë e madhe e lepujve femra zhvillojnë kancer të mitrës pas moshës dy vjeçare nëse nuk sterilizohen.

Një lepur mashkull mund të sterilizohet nga mosha tre muajsh, dhe një lepur femër mund të sterilizohet nga gjashtë muajsh.

# LISTA E VETERINERËVE NË SHQIPËRI

## SHKODËR

- Klinika Veterinare "PUTRAT", Dr. Rubin Piranaj, Adresa: Rruga Hoxha Tahsim, Kiras, Tel: +355 69 560 1111
- Klinika Veterinare "Shtëpia e Kafshëve", Dr. Sokol Malaj, te Peshku në Zdrallë +355 69 663 5528
- Klinika Veterinare « Lupo », Dr. Luan Gradeci, Adresa: Ura Dervishbeg, Tel: +355 69 441 8833
- Dr. Ylli Matija, Adresa: Kryqëzimi i Degës, Tel: +355 68 221 5775

## LEZHË

- Farmaci & Klinike veterinare "Vets+", Dr. Gjovalin Kaceli, Adresa: Rrilë, Lezhë, Tel: +355 69 239 2828
- Farmaci dhe Klinike veterinare "Vets +" nr.2, Dr. Nuen Kosova, Adresa: Dajç, Lezhë, Tel: +355 69 323 7031
- Farmaci dhe Klinike veterinare "Vets +" nr.3, Dr. Giosue Fiori, Adresa: Lezhë, Tel: +355 69 744 0358
- Farmaci Veterinare "Marku", Adresa: Rruga Franz Josef Strauss, Lezhë, Tel: +355 68 208 8748

## TIRANË

- Klinika "Pet Care", Dr. Dorina Kolleshi, Adresa: Rruga e Durrësit, Tel: +355 69 527 3262
- Klinika "Shtëpia e Kafshëve të Vogla", Adresa: Rruga Sulejman Delvina, Tel: +355 4 240 0672 ose +355 69 603 1333
- Klinika Veterinare Gogu, Adresa: Rruga Veteranet Nr. 17, Tel +355 69 347 4747
- O&B Vet Clinic, Dr. Olsi dhe Blerina, Adresa: Rruga Sami Frashër - Pallati 20, Tel: +355 67 711 1711 ose +355 68 405 3986
- Vet Hospital Tirana, Rruga Hiqmet Buzi, Pranë Liqenit të Thatë, Sauk Vjetër, Tiranë, +355 67 239 1111
- Klinika veterinare Bruna, Adresa: te Brryli, Tel: +355 69 925 1664
- International Pet Hospital Tirana, Adresa: Rruga e Elbasanit, pranë Akademisë së Policisë, përballë karburant Kastrati, Sauk, Tel: +355 4 246 8417
- Klinika Veterinare " Happy Pets", Adresa: Rruga Teodor Keko, Tel: +355 69 457 8228

## ELBASAN

- Klinike Veterinare "Bota e Kafshëve", Dr. Bled Oga, Tel: +355 69 858 5250
- Klinika Veterinare "Froklen", Adresa: Sheshi Zaranika, Tel: +355 68 215 6416

## DURRËS

- Klinika Veterinare "KLOER", Dr. Eror Zylyftari, Adresa: Rruga Jahja Ballhysa 622, Tel: +355 69 317 7929
- Klinika "Pet house 2000", Dr. Riva Recj, Adresa: Pallati i parë poshtë mbikalimit këmbësor të Portit, Tel: +355 69 211 0378
- Klinike Veterinare V.Osmani, Adresa: Rruga Abdulla Teku, Tel: +355 69 210 9873
- Klinike Veterinare "Quku", Adresa: Plepa, Tel: +355 69 225 0288

## **LUSHNJE**

- Kudret Gijshja (kryen operacione) Tel: +355 68 233 1062
- Shkenca Arapi, Tel: +355 69 543 3865
- Zamir Arapi
- Sandi Puka
- Jurgen Puka

## **BERAT**

- Dr. Ledio Bejleri, Tel: +355 69 727 4877
- Klinika Ferdinandi, Tel: +355 69 872 0402
- Klinikë Veterinare “Mimani”, Velabisht, Berat, +355 69 872 0402

## **FIER**

- Animal Veterinare Hospital, Dr. Luiza Hykaj, Adresa: Rruga Aulona (Hasan Tasini), Tel: +355 68 331 4179
- Dr. Artenis Limoj, Adresa: Blv Jakov Xoxa, Lagjja Konferenca e Pejës, Tel: +355 68 835 3760
- Farmaci Veterinare Ermali, Adresa: Rruga Brigada IX Sulmuese, Tel: +355 69 269 6371

## **VLORË**

- Klinikë Veterinare - Pet Care - Victoria, Dr. Diftir Tahiri, Adresa: Rruga Perlat Rexhepi 30, Tel: +355 69 586 4111
- Klinikë veterinare “Sinani”, Tel: +355 69 429 9744

## **GJIROKASTËR**

- Farmaci dhe klinikë veterinare “Animal Center”, Dr. Aedona dhe Dr. Trifon Bega, Tel: +355 69 652 6763
- Dr. Shemsho Lamaj, Tel: +355 69 820 9931

## **SARANDË**

- Klinikë & Farmaci Veterinare M.T.G, Dr. Tiziana Sina, Adresa: Rruga Abedin Dino, Tel: +355 69 329 6428
- Vet - Klinikë Veterinare - Doktor Putra, Adresa: Rruga 13 Birbilenjtë 9, Tel: +355 69 257 1570

## **POGRADEC**

- Dr. Emanueli: Tel: +355 69 223 4668
- Dr. Enida Misliu, Tel: +355 69 328 8975
- Dr. Kujtim Shparthi, Tel: +355 69 224 7896

## **KORÇË**

- Dr. Bektash Zhiva, Adresa: te rrethrotullimi i City Center, Tel: +355 69 221 9430
- Klinika Veterinare “Iliri”, Adresa: P.7, Lagjia 18, Rruga Kico Greco, Tel: +355 68 605 4540
- Dr. Mikeli dhe Dr. Arben Qafëzezi, Tel: +355 68 205 9749

## REFERENCAT

<https://www.britannica.com/animal/pet>

[kb.rspca.org.au](http://kb.rspca.org.au)

[Shepherd, K 2009. BSAVA Manual of Canine and Feline Behaviour, 2nd edition. pages 13 - 16. Editors Debra F. Horwitz and Daniel S. Mills](#)

The Kitten - Good Pet Guide, Magnet & Steel Ltd (2012)

The Puppy - Good Pet Guide, Magnet & Steel Ltd (2012)

[www.bluecross.org.uk](http://www.bluecross.org.uk)

[www.cats.org.uk](http://www.cats.org.uk)

[www.dogstrust.org.uk](http://www.dogstrust.org.uk)

[www.medivet.co.uk](http://www.medivet.co.uk)

<https://www.pdsa.org.uk/>



**Animals Need Me**

**2023**

**[www.animalsneedmealbania.com](http://www.animalsneedmealbania.com)**